Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

“Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

Shtojca 7

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

“Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;

c. Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;

ç Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;

d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;

dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7 të dokumentave të tenderit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Vlerësimi i gjendjes ekonomike e financiare të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a.** Kopje të deklarimit të xhiros mesatare vjetore gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2018, 2019**) nga data e zhvillimit të tenderit e cila duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se 980.790 (nëntëqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH lëshuar nga autoriteti përkatës.
- b.** Kopje të vërtetuara të bilanceve të dy viteve të fundit (2018, 2019) nga data e zhvillimit të tenderit të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet;
- c.** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019 dhe 2020 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar;

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Furnizime/ Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogarit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 392.316 (treqind e nëntëdhjetë e dy mijë e treqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

(Operatori ekonomik duhet të ketë si objekt të veprimtarisë së tyre aktivitetet në fushat/ sektorët ekonomikë të shërbimeve të shtypshkrimit, printimit apo tregëtimit të materialeve promovionale,

“Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

botimeve të ngjashme me to, e cila të vërtetohet nëpërmjet ekstraktit të regjistrit tregtar të lëshuar nga QKB-ja).

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Kur furnizimi/shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate.

Kur furnizimi/ shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore të shitjes të nënshkruar nga të dyja palët ku të shenohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara të nënshkruara nga të dyja palët.

2.3.2 Duke patur parasysh shërbimin e kërkuar për ofrimin e shërbimit të trajnimit, Operatori Ekonomik duhet të ketë një ekip të përbërë nga ekspertë dhe trajner, nga të cilët:

a. **1 (një) ekspert vlerësues dhe trajner ”Kërkim shkencor”**, me eksperiencë së paku mbi 1 vit në fushën e menaxhimit/kërkimit shkencor. Preferohet të ketë eksperiencë në trajnime lidhur me fushën e menaxhimit/kërkim shkencor. Të ketë aftësi drejtuese dhe aftësi lehtësuese të punës në grup, të jetë i aftë të bashkëpunojë në grup; të ketë aftësi shumë të mira komunikimi.

Për të vërtetuar këtë, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë vijon:

1. Kontratë pune e vlefshme/ kontratë premtim angazhimi
2. Diplomë (Të nivelit Msc) si dhe certifikime ose kualifikime në lidhje me fushën e tij.
3. Letër reference për realizimin e trajnimit në projekte të ngjashme të lëshuar nga subjekti përfitues.
4. CV

b. **1 (një) ekspert vlerësues dhe trajner ”Planifikim dhe menaxhim projekti”** me eksperiencë së paku mbi 1 vit në fushën e menaxhimit. Preferohet të ketë eksperiencë në trajnime lidhur me fushën e menaxhimit/ menaxhim projekti. Të ketë aftësi drejtuese dhe aftësi lehtësuese të punës në grup, të jetë i aftë të bashkëpunojë në grup; të ketë aftësi shumë të mira komunikimi. Të jetë ekspert i fushës në planifikim dhe menaxhim të projekteve.

1. Kontratë pune e vlefshme/ kontratë premtim angazhimi
2. Diplomë (Të nivelit Msc) dhe certifikime ose kualifikime në lidhje me fushën e tij.
3. Letër reference për realizimin e trajnimit në projekte të ngjashme të lëshuar nga subjekti përfitues
4. CV

“Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) punonjës për një periudhë 3 (tre) muajt e fundit (duke marrë si referencë datën e hapjes së ofertave). Kjo të vërtetohet duke paraqitur vërtetim lëshuar nga Administrata Tatimore, ku specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës garanton se shërbimi i ofruar do të jetë në përputhje të plotë me specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e references.

2.3.5 Operoret ekonomike duhet te paraqesin deklarate nga administratori i shoqerise per pajisjet teknike qe disponojne per realizimin e kontrates (projektit) duke percaktuar ne deklarate llojin dhe specifikimet teknike per cdo paisje te kerkuar.

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deklaratë nga administratori i shoqërisë se marrin përsipër transportimin, montimin, mbarëvajtjen teknike, çmontimin dhe largimin e pajisjeve pas përfundimit të aktivitetit e të gjitha pajisjeve teknike të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit (ne kuader te projektit) në vendin përkatës sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te paraqesë çertifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015**, ose e përditësuar (e vlefshme dhe e akredituar nga Organizma Kombëtare të Akreditimit ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë *ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit ambjentit”* në përputhje me objektin e prokurimit, ose i përditësuar (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë *BS OHSAS 18001:2007 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”* ose ekuivalente në përputhje me objektin e prokurimit, ose i përditësuar (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

2.3.8 Operatori ekonomik për të vërtetuar që ka kapacitetet teknike për të ekzekutuar kontratën duhet të disponojë makineritë e mëposhtme:

- makineri me bojra ekologjike
- makineri uv me llakim

Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore ose zhdoganimin. Për makineritë me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e lidhur para noterit, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e

“Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësit (fatura tatimore ose zhdoganimi).

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë fizikisht ditën dhe orën e hapjes së ofertave mostra për zërat si më poshtë vijon:

- 1. Filxhan mug, me logo projekti- 1(një) copë*
- 2. Stilolapsa me logo projekti-1(një) cope*
- 3. USB me logo projekti-1(një) copë*

Mosparaqitja e mostrave në ditën dhe orën e hapjes së ofertave është kusht për s’kualifikim.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

“Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

Shtojca 8

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“BLERJE SHËRBIMI PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT, “FILLO ME NJË IDE-FITO NJË INTERSHIP NË BASHKINË E TIRANËS”

1. Fushatë publicitare për promovimin e projektit:

- a- Banner Roll UP me logon e projektit. i pajisur me mekanizëm mbajtës, me dimensione 85cm gjerësi x 200 cm gjatësi. Me aksesore alumin, jo më shumë se 2 kg dhe i pajisur me çantën për transport – 2 copë (referuar pikës/zërit nr. 1 në preventiv)
- b- Banner muri me strukturë telajo druri me vetëqëndrim, me përmasa (bojëra ekologjike) (5 m x 3 m) – 1 copë (referuar pikës/zërit nr.2 në preventiv)

2. Materiale kancelarie në funksion të zhvillimit të projektit:

- 1. Letër A4, me ngjyra (rozë, jeshile, portokalli, bojëqielli, e verdhë (Nga 2 rizma për secilën ngjyrë.) - 10 rizma (referuar pikës/zërit nr. 3 në preventiv)
- 2. Markera white board për përdorim në Flip Chart me ngjyrë të zezë, blu, jeshil, të kuq. (35 per secilën ngjyre) – 140 copë (referuar pikës/zërit nr. 4 në preventiv)
- 3. Stilolapsa me logo projekti, stilolapës me sustë, me mbajtëse dhe unazë metalike, me majën jo të hollë, ngjyra e bojës bojëqielli– 200 copë (referuar pikës/zërit nr. 5 në preventiv)
- 4. Çanta rrobë me logo projekti dhe logon e BT – 50 copë (referuar pikës/zërit nr. 6 në preventiv)
- 5. Bllok shënimesh me logo projekti, me përmasa 21 cm x 15 cm, të ketë minimalisht 75 fletë, me kapak dhe me spirale mbajtëse – 100 copë (referuar pikës/zërit nr. 7 në preventiv)
- 6. Filxhan mug me logon e projektit dhe logon e BT, filxhan – 85 copë (referuar pikës/zërit nr. 8 në preventiv)
- 7. Cd me kapak të prindtuar logon e projektit – 30 copë (referuar pikës/zërit nr. 9 në preventiv)
- 8. USB 32 giga me logon e projektit – 50 copë (referuar pikës/zërit nr. 11 në preventiv)
- 9. Spila me logon e projektit, me diametër 5.5 cm – 50 copë (referuar pikës/zërit nr. 12 në preventiv)
- 10. Toner laser Jet CE 285 A – 2 copë (referuar pikës/zërit nr. 13 në preventiv)

3. Botime në funksion të projektit :

“Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

a- Botime libër, format A4, i formatuar dhe dizenuar sipas kërkesës së autoritetit kontraktor në momentin e finalizimit të projektit – 25 copë (referuar pikës/zërit nr. 13 në preventiv)

b- Certifikata, letër format A4 me peshe 300 gr, ngjyrë pana e lehtë e dizenuar sipas kërkesës së autoritetit kontraktor në momentin e finalizimit të projektit (referuar pikës/zërit nr. 10 në preventiv)

4. Trajnime dhe module– Për më shumë specifikime referoju (Termave të referencës sipas shtojcës 11)

- Ekspert vlerësues dhe trajner (referuar pikës/zërit nr. 15 në preventiv)

a- Ekspert vlerësues dhe trajner “Planifikim dhe Menaxhim Projekti”

Eksperienca e kërkuar për Ekspert Vlerësues dhe Trajner: kërkohet me eksperiencë së paku mbi 1 vit në fushën e menaxhimit. Preferohet të ketë eskperiencë në trajnime lidhur me fushën e menaxhimit/ menaxhim projekti. Të ketë aftësi drejtuese dhe aftësi lehtësuese të punës në grup, të jetë i aftë të bashkëpunoj në grup; të ketë aftësi shumë të mira komunikimi. Të jetë ekspert i fushës në planifim dhe menaxhim të projekteve.

Të ketë mbaruar arsimin e lartë.

Të ketë mbi 1 vit eksperiencë pune në fushën e kërkuar.

Të zotërojë certifikime ose kualifikime në lidhje me fushën e tij.

Preferohet të ketë eskperiencë në trajnime lidhur me fushën e menxhimit/menaxhimit të projekteve.

Të ketë aftësi drejtuese dhe aftësi lehtësuese të punës në grup, të jetë i aftë të bashkëpunoj në grup; të ketë aftësi shumë të mira komunikimi.

Kohëzgjatja e kursit të trajnimit: 2 (dy) ditë.

Krijimi i të paktën 5 (pesë) moduleve të trajnimit.

Pjesëmarrja në cilësinë e anëtarit në të paktën 5 (pesë) Komitete Vlerësuese.

b- Ekspert vlerësues dhe trajner “Kërkim Shkencor”

Eksperienca e kërkuar për Ekspert Vlerësues dhe Trajner: kërkohet me eksperiencë së paku mbi 1 vit në fushën e menaxhimit/kërkimit shkencor. Të ketë aftësi drejtuese dhe aftësi lehtësuese të punës në grup, të jetë i aftë të bashkëpunoj në grup; të ketë aftësi shumë të mira komunikimi.

Të ketë përfunduar Arsimin e lartë.

Të ketë mbi 1 vit eksperiencë pune në fushën e kërkuar.

Të zotërojë certifikime ose kualifikime në lidhje me fushën e tij.

“Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

Preferohet të ketë eskperiencë në trajnime lidhur me fushën e menaxhimit/kërkim shkencor.

Të ketë aftësi drejtuese dhe aftësi lehtësuese të punës në grup, të jetë i aftë të bashkëpunoj në grup; të ketë aftësi shumë të mira komunikimi.

Kohëzgjatja e kursit të trajnimit: 2 (dy) ditë.

Krijimi i të paktën 5 (pesë) moduleve të trajnimit.

Pjesëmarrja në cilësinë e anëtarit në të paktën 5 (pesë) Komitete Vlerësuese.

5. Shërbimi në funksion të aktivitetit/ projektit (referuar pikës/zërit nr. 16 në preventiv)

a. Organizimi i Konkursit dhe lançimi i projektit:

- Ambient për zhvillimin e aktivitetit, me kapacitet mbajtës minimalisht për 100 persona, me hapësirë për krijimin e panelit dhe vendosjen e bazës materiale.
- Pushim kafe për 50 persona
- Katering për 50 persona
- Foni, projektor

b. Organizimi i aktivitetit përmbyllës:

- Katering për 45 persona
- Pushim kafe – 2 x 25 persona

c. Trajnim në Kërkim Shkencor:

- Pushim Kafe për 25 persona
- Katering për 25 persona

d. Trajnim në Planifikim dhe Menaxhim Projekti:

- Pushim Kafe për 25 persona
- Katering për 25 persona

“Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

“Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

Shtojca 10

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

“BLERJE SHËRBIMI PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT, “FILLO ME NJË IDE-FITO NJË INTERSHIP NË BASHKINË E TIRANËS”

Nr.	PËRSHKRIMI	NJËSIA	SASIA
1	Banner Roll UP me logon e projektit	Copë	2
2	Baner Muri me strukturë 5m*3 m	Copë	1
3	Letër format A4 me ngjyra (rozë, jeshile, portokalli, bojqielli,e verdhë).	Rrizma	10
4	Markera white board për përdorim në Flip Chart me ngjyrë të zezë, blu, jeshil, të kuq.	Fletë	140
5	Stilolapsa me logo projekti	Copë	200
6	Canta rrobë me logo projekti,	Copë	50
7	Blllok shënimesh me logo projekti 21*15,75 fletë	Copë	100
8	Filxhan mug, me logo projekti	Copë	85
9	Cd me kapak të printuar logon e projektit.	Copë	35
10	Certifikata (letër A4 300 gr)	Copë	25
11	USB me logo projekti	Copë	50
12	Spila me logo projekti	Copë	50
13	Toner laser Jet CE 285 A	Copë	2
14	Botime libër, format A4, I formatuar,	Copë	30
15	2 Ekspert vlerësues dhe trajner	Shërbim	2
16	Shërbim në funksion të aktivitetit sipas termave të referencës	Shërbim	1

Grafiku i lëvrimet:

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 6 (gjashtë) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

“Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

Shtojca 11

TERMAT E REFERENCËS

“BLERJE SHËRBIMI PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT, “FILLO ME NJË IDE-FITO NJË INTERSHIP NË BASHKINË E TIRANËS”

Projekti “Fillo me një ide - Fito një intership në Bashkinë Tiranë” dhe Udhëzuesi Operacional, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 29 datë 03.05.2019

Krijim moduli dhe materialesh trajnim, ofrim dhe vlerësim i trajnimit”Planifikim dhe Menaxhim Projekti”, pjesëmarrje në cilësinë e anëtarit në Komitete Vlerësuese

- A. Pozicion: Ekspert vlerësues dhe trajner “Planifikim dhe Menaxhim Projekti”
- B. Vendndodhja: Tiranë
- C. Referenca e Projektit: Projekti “Fillo me një ide- Fito një intership në Bashkinë Tiranë” dhe Udhëzuesi Operacional, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 29 datë 03.05.2019
- D. Kohëzgjatja: - Projekti do të fillojë në Qershor 2020
- E. Përshkrim i shkurtër i projektit: Bashkia Tiranë po implementon projektin “Fillo me një ide- Fito një intership në Bashkinë Tiranë” Thirrja III. Qëllimi i këtij projekti është që të rinj në fillim të karrierës së tyre profesionale të fitojnë një eksperiencë pune në Bashkinë Tiranë, duke u ofruar mundësinë që të zhvillojnë aftësitë e tyre analitike dhe kërkimore përmes konkurrimit me një koncept ide për projekt ose studim në një nga fushat e veprimtarisë së Bashkisë Tiranë. Të rinjtë do të kenë mundësi të përgatisin dhe të dorëzojnë një propozim të plotë teknik dhe financiar të projektit si dhe të përfundojnë studimin gjatë intershipit duke bashkëpunuar nga afër me stafin e Bashkisë për një periudhë 3 mujore praktike pune. Ky projekt u mundëson 20 të rinjve dhe të rejave të grupmoshës deri në 28 vjeç të zhvillojnë praktikë pune dhe të fitojnë një çmim gjatë një angazhimi 3 mujor pranë Bashkisë Tiranë duke dorëzuar në fund të këtij angazhimi propozimet e plota për projekt dhe studimet e plota. Të gjitha propozimet (koncept-ide për projekt/studim) do të vlerësohen nga një Komitet Vlerësues i ngritur në nivel njësie organizative. Rezultatet e konkurrimit do të shpallen gjatë një aktiviteti publik të organizuar nga Bashkia Tiranë. Trajnimet mbi “Planifikim dhe Menaxhim Projekti” dhe “Kërkim shkencor” janë pjesë e veprimtarisë formuese të studentëve (20 të rinj), të cilët do të shpallen fitues në këtë projekt.

“Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

F. Kriteret për përzgjedhjen e ofertave duhet të bazohen në këto të dhëna (specifikimet teknike të mallit/shërbimit/punës):

- Niveli i kursit të trajnimit: fillestar
- Kohëzgjatja e kursit të trajnimit: 2 (dy) ditë
- Numri maksimal i pjesëmarrësve: 20 persona
- Gjuha e trajnimit: shqip
- Curriculum-Vitae të Ekspertit Vlerësues dhe Trajner
- Eksperienca e kërkuar për Ekspert Vlerësues dhe Trajner: kërkohet me eksperiencë deri në 1 vit në fushën e menaxhimit. Preferohet të ketë eksperiencë në trajnime lidhur me fushën e menaxhimit/ menaxhim projekti. Të ketë aftësi drejtuese dhe aftësi lehtësuese të punës në grup, të jetë i aftë të bashkëpunoj në grup; të ketë aftësi shumë të mira komunikimi.
- Objektivat e trajnimit: Pas trajnimit pjesëmarrësit duhet të jenë të aftë të kuptojnë bazat e menaxhimit të projektit: si të fillojnë, si të planifikojnë dhe si të zbatojnë një projekt që arrin qëllimin dhe objektivat e përcaktuara.
- Plani i trajnimit: titulli i trajnimit; përshkrim i trajnimit; objektivat e të mësuarit; temat e trajnimit (outline); kohëzgjatja e trajnimit; pjesëmarrësit; materialet e trajnimit (slidet); logjistika e trajnimit
- Numri i moduleve të trajnimit: jo më pak se 3 (tre) module
- Tema e modulit të trajnimit: tema e modulit të trajnimit duhet të adresojë arritjen e objektivave të trajnimit.
- Objektivat e ekspertit vlerësues: pjesëmarrje në Komitete Vlerësuese dhe ofrimi i ekspertizës në vlerësimin e koncept- ideve për projekt/studim duke siguruar prezencën në çdo takim pune të anëtarëve të Komitetit Vlerësues dhe duke siguruar ushtrimin e detyrave bazuar në parimin e ruajtjes së konfidencialitetit dhe shmangies së konfliktit të interesit; hartimi dhe nënshkrimi i formularëve individual për vlerësimin sipas kriterëve të çdo koncept ideje për projekt/studim dhe përgatitja e tabelës përmbledhëse të vlerësimit.

G. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- a. Krijimi i të paktën 3 (tre) moduleve të trajnimit
- b. Ofrimi i një trajnimi 2 (dy) ditor “Planifikim dhe Menaxhim Projekti”
- c. Pjesëmarrja në cilësinë e anëtarit në Komitete Vlerësuese

“Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

1. R SPECIFIKIME PËR EKSPERT VLERËSUES DHE TRAJNER

Kërkim shkencor

Projekti “Fillo me një ide- Fito një intership në Bashkinë Tiranë” dhe Udhëzuesi Operacional, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 29 datë 03.05.2019

Krijim moduli dhe materialesh trajnim, ofrim dhe vlerësim i trajnimit “Kërkim Shkencor”, pjesëmarrje në cilësinë e anëtarit në Komitete Vlerësuese

- A. Pozicion: Ekspert vlerësues dhe trajner” Kërkim shkencor”
- B. Vendndodhja: Tiranë
- C. Referenca e Projektit: Projekti “Fillo me një ide- Fito një intership në Bashkinë Tiranë” dhe Udhëzuesi Operacional, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 29 datë 03.05.2019
- D. Kohëzgjatja: - Projekti do të fillojë në Qershor 2020
- E. Përshkrim i shkurtër i projektit: Bashkia Tiranë po implementon projektin “Fillo me një ide- Fito një intership në Bashkinë Tiranë” Thirrja III. Qëllimi i këtij projekti është që të rinj në fillim të karrierës së tyre profesionale të fitojnë një eksperiencë pune në Bashkinë Tiranë, duke u ofruar mundësinë që të zhvillojnë aftësitë e tyre analitike dhe kërkimore përmes konkurrimit me një koncept ide për projekt ose studim në një nga fushat e veprimtarisë së Bashkisë Tiranë. Të rinjtë do të kenë mundësi të përgatisin dhe të dorëzojnë një propozim të plotë teknik dhe financiar të projektit si dhe të përfundojnë studimin gjatë intershipit duke bashkëpunuar nga afër me stafin e Bashkisë për një periudhë 3 mujore praktike pune. Ky projekt u mundëson 20 të rinjve dhe të rejave të grupmohës deri në 28 vjeç të zhvillojnë praktikë pune dhe të fitojnë një çmim gjatë një angazhimi 3 mujor pranë Bashkisë Tiranë duke dorëzuar në fund të këtij angazhimi propozimet e plota për projekt dhe studimet e plota. Të gjitha propozimet (koncept-ide për projekt/studim) do të vlerësohen nga një Komitet Vlerësues i ngritur në nivel njësie organizative. Rezultatet e konkurrimit do të shpallen gjatë një aktiviteti publik të organizuar nga Bashkia Tiranë. Trajnimet mbi “Planifikim dhe Menaxhim Projekti” dhe “Kërkim shkencor” janë pjesë e veprimtarisë formuese të studentëve (20 të rinj), të cilët do të shpallen fitues në këtë projekt.
- H. **Kriteret për përzgjedhjen e ofertave duhet të bazohen në këto të dhëna (specifikimet teknike të mallit/shërbimit/punës):**
 - A. Niveli i kursit të trajnimit: fillestar
 - B. Kohëzgjatja e kursit të trajnimit: 2 (dy) ditë
 - C. Numri maksimal i pjesëmarrësve: 20 persona

“Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

- D. Gjuha e trajnimit: shqip
- E. Curriculum-Vitae të Ekspertit Vlerësues dhe Trajner
- F. Eksperienca e kërkuar për Ekspert Vlerësues dhe Trajner: kërkohet me eksperiencë deri në 1 vit në fushën e menaxhimit/kërkimit. Preferohet të ketë eksperiencë në trajnime lidhur me fushën e menaxhimit/ kërkimit shkencor. Të ketë aftësi drejtuese dhe aftësi lehtësuese të punës në grup, të jetë i aftë të bashkëpunoj në grup; të ketë aftësi shumë të mira komunikimi.
- G. Objektivat e trajnimit: Pas trajnimit pjesëmarrësit duhet të jenë të aftë të artikulojnë qartësisht një pyetje kërkimi /studimi ose një problem dhe të formulojnë hipoteza; të identifikojnë metodologji të ndryshme kërkimi/studimi; të njohin koncepte bazë të fushës së kërkimit shkencor; të përdorin aftësi në zgjidhjen e problemeve; të reflektojnë mbi kërkimin e tyre, duke parë mundësi për përmirësim, pikat e forta dhe të dobta; të artikulojnë rëndësinë e punës së tyre dhe ta prezantojnë atë tek palët e interesuara;
- H. Plani i trajnimit: titulli i trajnimit; përshkrim i trajnimit; objektivat e të mësuarit; temat e trajnimit (outline); kohëzgjatja e trajnimit; pjesëmarrësit; materialet e trajnimit (slidet); logjistika e trajnimit
- I. Numri i moduleve të trajnimit: jo më pak se 3 (tre) module
- J. Tema e modulit të trajnimit: tema e modulit të trajnimit duhet të adresojnë arritjen e objektivave të trajnimit.
- K. Objektivat e ekspertit vlerësues: pjesëmarrje në Komitete Vlerësuese dhe ofrimi i ekspertizës në vlerësimin e koncept- ideve për projekt/studim duke siguruar prezencën në çdo takim pune të anëtarëve të Komitetit Vlerësues dhe duke siguruar ushtrimin e detyrave bazuar në parimin e ruajtjes së konfidencialitetit dhe shmangies së konfliktit të interesit; hartimi dhe nënshkrimi i formularëve individual për vlerësimin sipas kriterëve të çdo koncept ideje për projekt/studim dhe përgatitja e tabelës përmbledhëse të vlerësimit.
- L. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:
 - d. Krijimi i së paku 3 (tre) moduleve të trajnimit
 - e. Ofrimi i një trajnimi 2 (dy) ditor “Kërkim Shkencor”
 - f. Pjesëmarrja në cilësinë e anëtarit në Komitete Vlerësuese

“Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

Shtojca 12

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR³

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

³ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

“Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

Shtojca 13

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

“Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

“Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

Shtojca 14

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

“Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj.____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

“Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

Shtojca 15.

KUSHTET E PËRGJITHSHME Shërbimet –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruarra me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

“Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premteton ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6 Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si

